

2017

# Raport Vjetor për Raportim të Pasqyrave Financiare (viti financiar 2017)

*Këshilli Kosovar për Raportim Financiar  
(KKRF)*





Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

*Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosova*

**Ministria e Financave**

*Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF)*

## **Përmbajtja:**

<b>I. Hyrje .....</b>	<b>1</b>
<b>II. Indikatorë bazik të ndërmarrjeve të mëdha në Kosovë.....</b>	<b>1</b>
<i>II.1. Pasuritë.....</i>	<i>1</i>
<i>II.2. Të hyrat (qarkullimi) .....</i>	<i>2</i>
<i>II.3. Fitimi, Humbja dhe Tatimi .....</i>	<i>2</i>
<i>II.4. Forma e regjistrimit të shoqërive tregtare të mëdha në Kosovë dhe ndarja .....</i>	<i>5</i>
<i>në sektore.....</i>	<i>5</i>
<b>III. Indikatorë bazik të raporteve të auditimit të ndërmarrjeve të.....</b>	<b>6</b>
<b>mëdha në Kosovë .....</b>	<b>6</b>



## I. Hyrje

Bazuar në Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nr. 04/L-014, pasqyrat financiare të shoqërive tregtare të mëdha në Kosovë duhet të auditohen në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, nga firmat e auditimit të licencuara nga KKRF-ja. Njëkohësisht konform nenit 11 të Ligjit, shoqëritë tregtare të mëdha obligohen që të dorëzojnë dhe të publikojnë pasqyrat financiare pranë Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF). Pasqyrat financiare të shoqërive tregtare të mëdha duhet të përgatiten konform Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK). Pasqyrat financiare të dorëzuara pranë KKRF-së janë pjesë përbërëse e regjistrit të pasqyrave financiare vjetore në nivel të vendit. Regjistri vjetor i pasqyrave financiare shërben si burim qendror i informatave të aktivitetit të shoqërive tregtare të mëdha në Kosovë pozitës dhe performancës së tyre financiare. Duhet theksuar që të gjitha shoqëritë tregtare të licencuara nga Banka Qëndrore e Kosovës, nuk janë subjekt i ligjit aktual në fuqi për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Qëllimi kryesor i krijimit të një regjistri vjetor të pasqyrave financiare, është ngritja e transparencës financiare të shoqërive tregtare të mëdha të cilat kanë ndikim të konsiderueshëm në ekonominë e vendit. Prandaj formimi i një regjistri të këtillë është një hap drejt harmonizimit të legjislacionit të Kosovës me atë të vendeve të Bashkimit Evropian. Afati për dorëzimin e pasqyrave financiare të shoqërive tregtare të mëdha është data 30 prill i vitit vijues. Sa i përket shoqërive tregtare të mëdha të cilat obligohen të përgatisin pasqyra financiare të konsoliduara, afati për dorëzim të këtyre pasqyrave është 30 qershor i vitit vijues.

Numri i shoqërive tregtare të mëdha të cilat kanë dorëzuar pasqyrat financiare pranë KKRF-së për vitin financiar që përfundon më **31 dhjetor 2016 është 345**, (gjithsej total janë dorëzuar 345 raporte financiare duke përfshirë këtu disa subjekte ekonomike që i përkasin edhe kategorisë së shoqërive tregtare të mesme) duke përfshirë bankat dhe shoqëritë e sigurimit të cilat nuk janë subjekt i Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim. Ndërsa, shoqëritë tregtare të mëdha të cilat kanë dorëzuar pasqyrat financiare për vitin financiar që përfundon më **31 dhjetor 2017 është 361**, (gjithsej total janë dorëzuar 361 raporte financiare duke përfshirë këtu disa subjekte ekonomike që i përkasin edhe kategorisë së shoqërive tregtare të mesme) duke përfshirë bankat dhe shoqëritë e sigurimit të cilat nuk janë subjekt i Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.



## II. Indikatorë bazik të ndërmarrjeve të mëdha në Kosovë


Tabela 1: Rezultatet Financiare të Shoqërive Tregtare në Kosovë (vlerat në '000)

Përshkrimi	2017	2016	Ndryshimi (%)
Qarkullimi (të hyrat)	€ 5,185,144	€ 4,761,726	9%
Pasuritë	€ 5,092,984	€ 4,669,897	9%
Fitimi para tatimit (FPT)	€ 287,296	€ 327,579	-12%
Humbja para tatimit	-€ 24,773	-€ 42,406	-42%
Tatimi në fitim	€ 31,356	€ 36,383	-14%
Fitimi pas tatimit	€ 258,843	€ 294,748	-12%
Humbja pas tatimit	-€ 25,461	-€ 27,801	-8%
Numri i të punësuarve	49	46	6%

### II.1. Pasuritë

Bazuar në të dhënat e tabelës 1 dhe grafikut 1 vlera e pasurive të shoqërive tregtare të mëdha në vitin 2016 ishte €4.67 miliardë, ndërsa në vitin 2017 kjo kategori e bilancit të gjendjes arriti vlerën prej €5.10 miliardë. Ky ndryshim nënkupton që pasuritë e të gjitha ndërmarrjeve të mëdha në Kosovë janë rritur për 9% krahasuar me vitin paraprak.


Grafiku 1: Lëvizja e aseteve e shoqërive tregtare të mëdha viti 2016/2017 (vlerat në '000€)



## II.2. Të hyrat (qarkullimi)

Bazuar në të dhënat e tabelës 1 dhe grafikut 2, në vitin 2016, shoqëritë tregtare të mëdha në Kosovë kanë realizuar të hyra totale në vlerë prej €4.76 miliardë. Në vitin 2017 të hyrat arritën në €5.19 miliardë, vlerë e cila krahasuar me vitin 2016 ka shënuar një rritje prej 9%. Kjo nënkupton që ndërmarrjet e mëdha në Kosovë kanë treguar performancë pozitive sa i përket totalit të shitjeve të produkteve apo ofrimit të shërbimeve gjatë vitit 2017.


**Grafiku 2: Lëvizja e të hyrave të shoqërive tregtare të mëdha viti 2016/2017 (vlerat në '000€)**




## II.3. Fitimi, Humbja dhe Tatimi

Bazuar në të dhënat e tabelës 1 dhe grafikut 3, për këtë kategori të shoqërive tregtare, fitimi para tatimit (FPT) në vitin 2016 ishte €327.58 milion, ndërsa në vitin 2017 fitimi para tatimit (FPT) ishte €287.30 milion, duke shënuar rënie 12% krahasuar me vitin paraprak. Kjo nënkupton që ndërmarrjet e mëdha kanë pasur më shumë shpenzime operative dhe shpenzime tjera gjatë vitit 2017 krahasuar me vitin 2016 dhe si rezultat i kësaj FPT ka pësuar rënie.




**Grafiku 3: Fitimi para tatimit të shoqërive tregtare të mëdha viti 2016/2017 (vlerat në '000€)**

Bazuar në të dhënat e tabelës 1 dhe grafikut 4, për këtë kategori të shoqërive tregtare, fitimi pas tatimit apo fitimi neto në vitin 2016 ishte €294.75 milion, ndërsa në vitin 2017 fitimi pas tatimit ishte €258.84 milion, duke shënuar rënie 12%. Kjo përsëri mund të jetë si pasojë e rritjes së nivelit të shpenzimeve të kësaj kategorie të ndërmarrjeve gjatë vitit 2017.

**Grafikun 4: Fitimi pas tatimit të shoqërive tregtare të mëdha viti 2016/2017 (vlerat në '000€)**


Tatimi në fitim për shoqëritë tregtare të mëdha për vitin 2017 ishte në vlerë prej €31.36 milion, në rënie prej 14% nga viti 2016.

**Grafikun 5: Tatimi në fitim të shoqërive tregtare të mëdha viti 2016/2017 (vlerat në '000€)**



Vlen të theksohet edhe roli i rëndësishëm i shoqërive tregtare të mëdha në tregun e punësimit në Kosovë (grafiku 6), duke punësuar total prej rreth 49 mijë punonjës në vitin 2017, ndërsa në vitin 2016, totali i punonjësve ishte rreth 46 mijë. Numri i punonjësve shënoi rritje gjatë vitit 2017 në lartësi prej 6%.

**Grafikun 6: Numri i të punësuarve 2016/2017 (vlerat në '000)**



#### II.4. Forma e regjistrimit të shoqërive tregtare të mëdha në Kosovë dhe ndarja në sektore

Bazuar në të dhënat e tabelës 2, lloji më i sheshtë i formës së organizimit të shoqërive tregtare të mëdha në Kosovë është ajo e 'shoqërive me përgjegjësi të kufizuar' që përfaqëson 78.1% të të gjitha shoqërive tregtare të mëdha të cilat kanë dorëzuar pasqyrat financiare në KKRF. Ndërsa lloji më i rrallë është ai i 'ortakërive' me një nivel prej 2.2%, i pasuar me llojin e 'biznesit individual' me një nivel prej 9.7% dhe llojin e 'shoqërive aksionare' me një nivel prej 10%.

*Tabela 2: Format e organizimit të shoqërive tregtare të mëdha në vitin 2017*

Përshkrimi	2017	Përqindja
Biznes individual	35	9.7%
Ortakëri	8	2.2%
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar	282	78.1%
Shoqëri aksionare	36	10.0%
<b>TOTALI</b>	<b>361</b>	<b>100%</b>

Bazuar në të dhënat e tabelës 3, 92.2% e të gjitha shoqërive tregtare të mëdha në Kosovë të cilat kanë dorëzuar pasqyrat financiare në KKRF janë të sektorit privat, ndërsa vetëm 7.8% janë të sektorit publik. Kjo statistikë tregon që sektori privat ka një dominim absolut në tregun e kategorisë së shoqërive tregtare të mëdha në Kosovë.

*Tabela 3: Ndarja sipas sektorëve*

Përshkrimi	2017	Përqindja
Sektori privat	333	92.2%
Sektori publik	28	7.8%
<b>TOTALI</b>	<b>361</b>	<b>100%</b>

Bazuar në të dhënat e tabelës 4, 52.7% e të gjitha shoqërive tregtare të mëdha në Kosovë të cilat kanë dorëzuar pasqyrat financiare në KKRF janë ndërmarrje të cilat merren me tregti, ndërsa vetëm 31.5% e ndërmarrjeve janë të cilat merren me

prodhim dhe 15.8% merren me ofrimin e shërbimeve. Kjo statistikë tregon që mbi 50% e të gjitha ndërmarrjeve të mëdha në Kosovë kryejnë veprimtari tregtare.

*Tabela 4: Ndarja sipas industrisë*

<b>Përshkrimi</b>	<b>2017</b>	<b>Përqindja</b>
Prodhim	114	31.5%
Tregti	57	15.8%
Shërbime	186	52.7%
<b>TOTALI</b>	<b>361</b>	<b>100%</b>

### **III. Indikatorë bazik të raporteve të auditimit të ndërmarrjeve të mëdha në Kosovë**

Në vijim janë prezantuar rezultatet e analizës së llojit të firmave të auditimit të cilat kanë bërë auditimin e shoqërive tregtare të mëdha në Kosovë për vitin financiar 2017. Bazuar në të dhënat përmbledhëse në tabelën 6, vërehet që në vitin 2017 firmat vendore të auditimit kanë lëshuar opinion për 254 shoqëri tregtare të mëdha, përkatësisht për 70.4% të të gjitha ndërmarrjeve të kësaj kategorie. Ndërkaq, firmat e huaja të auditimit kanë lëshuar opinione për 107 shoqëri tregtare të mëdha, përkatësisht për 29.6% të të gjitha ndërmarrjeve të kësaj kategorie. Kjo statistikë tregon që pjesa dërmuese e shoqërive tregtare të mëdha në Kosovë janë audituar nga firmat vendore të licencuara të auditimit.

*Tabela 5: Lloji i firmës së auditimit*

<b>Përshkrimi</b>	<b>2017</b>	<b>Përqindja</b>
Firmë e huaj	107	29.6%
Firmë vendore	254	70.4%
<b>TOTALI</b>	<b>361</b>	<b>100%</b>

Në tabelën 6 janë prezantuar rezultatet e analizës së llojit të opinioneve të lëshuara nga auditorët. Bazuar në të dhënat përmbledhëse në tabelën 6, vërehet që në vitin 2017 numri i opinioneve të pakualifikuara ka qenë 219 (60.6%), numri i opinioneve të kualifikuara ka qenë 131 (36.2%), numri i opinioneve të kundërta ka qenë 1 (0.4%) si dhe numri i mohimeve të opinionit ka qenë 10 (2.8%). Kjo statistikë

tregon që rreth 60% të ndërmarrjeve të mëdha në Kosovë kanë pasur pasqyra financiare të cilat kanë qenë plotësisht në pajtueshmëri me SNRF/SNK. Sa i përket kategorisë së opinionëve të kualifikuara, duhet theksuar që arsyet më të shpeshta që kanë shpirë në kualifikim kanë qenë: (i) mos prezenca në numërimin e stoqeve, (ii) vlerësimi i patundshmërive, impianteve dhe pajimeve, (iii) mos provizionimi i llogarive të arkëtueshme, (iv) detyrimet akruale, (v) tatimi i shtyrë, etj.

*Tabela 6: Lloji i opinionit të dhënë*

<b>Përshkrimi</b>	<b>2017</b>	<b>Përqindja</b>
I pakualifikuar	219	60.6%
I kualifikuar	131	36.2%
I Kundërt	1	0.4%
Mohim i opinionit	10	2.8%
<b>TOTALI</b>	<b>361</b>	<b>100%</b>